



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

I përmbledhur¹

Tiranë, më 11.12.2020, ora 13:00

Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së datës 20.10.2020, procesverbalit të shortit, si dhe i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së datës 07.12.2020.

2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.2020:

- Klajdi Mone,
- Përparim Kalo.

3. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.

4. Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020.

5. Miratimi i ekspertit të gjuhës së huaj në funksion të realizimit të intervistave me kandidatin e lejuar.

6. Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës së kandidatit të lejuar.

7. Zhvillimi i intervistës me kandidatin për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020, si më poshtë:

- Altin Binaj.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226, pika 1, shkronja "d", neni 232, pika 2, neni 242, shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED-së për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED-ja disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhjeje, sipas ligjit.

8. *Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja për kandidatin e lejuar.*

9. *Diskutimi dhe miratimi i listës përfundimtare të renditjes, si dhe i raportit përkatës.*

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|--------------------|
| 1. Vitore Tusha | (zëvendëskryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Ludovik Dodaj | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. **Erinda Ballanca**, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.
2. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

HAPET MBLEDHJA

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës që është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Bën me dije se mungon anëtarja Fajtona Memçaj, për arsye familjare. Fton anëtarët të miratojnë rendin e ditës.

Anëtarët miratojnë rendin e ditës.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe shprehet se është dakord me rendin e ditës dhe se ka një propozim në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, por që mund të diskutohet në fund të mbledhjes, te çështje të tjera të rendit të ditës.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet: “Paraprakisht kam diçka, por pasi të kalojmë pikat 1-2-3 të rendit të ditës. Mund ta them edhe tani, se nuk ka asnjë gjë të keqe. Doja të dija nëse ju pas pikës 3 do të vijoni me pikën 4, apo më parë do të futeni në dhomën e këshillimit për diskutim e vendimmarrje? Kjo sepse ajo që dua të them në atë moment i leverdis më pas edhe procedurës suaj sipas pikave 4-5 e më tutje të rendit të ditës, që varet nga vendimmarrja e këshillit, për lejimin ose ndalimin nga kandidimi”.

Anëtarët bien dakord të vazhdohet me rendin e ditës.

Vitore Tusha vijon me rendin e ditës, miratimin e procesverbaleve, të cilat janë komunikuar dhe janë përfshirë në to edhe komentet, edhe vërejtjet e paraqitura.

Anëtarët miratojnë procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së datës 20.10.2020 dhe procesverbalin e shortit, si dhe procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes të datës 07.12.2020.

Vitore Tusha vijon me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datat 27.09.2019 dhe 24.09.2020.

Në cilësinë e relatores së kësaj vakance relaton procedurën e ndjekur për kandidatin Klajdi Mone. Lexon të plotë relacionin. Sqaron se relacioni i është njoftuar kandidatit,

anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë sipas ligjit dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Pyet nëse ka pyetje apo sqarime.

Anëtarët nuk kanë pyetje apo sqarime.

Erinda Ballanca shprehet se e falënderon relatorin për relatimin, pasi ishte shumë i plotë, dhe ka një pyetje për gjetjet për sa i përket fushës së integritetit “Mund të më shpjegoni se si ka ecur çështja e deklasifikimit, pra herën e parë u deklasifikua pjesërisht ky informacion, herën e dyte pati një deklasifikim pak më të plotë?”.

Vitore Tusha përgjigjet se Këshillit i erdhi një shkresë e dytë me më shumë të dhëna.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Shkresa e dytë ka më shumë të dhëna dhe hedh dritë në lidhje me periudhën kur ka ndodhur ngjarja e pretenduar apo kur është mbledhur informacioni i klasifikuar që i përket vitit 2010 që nga viti 2010 dhe deri më sot ka pasur ndonjë hetim penal në lidhje me këtë çështje, qoftë për Klajdin, qoftë për personat që kanë qenë të konsideruar si persona të përshtirë në këtë situatë? Kjo ishte pyetja ime. A del nga hetimi një gjë e tillë? Se në pamje të parë ka një periudhë relativisht të gjatë kohe në gjykimin tim dhe nëse do të kishte një aktivitet kriminal qartësisht do të duhej që të ishte referuar rasti, të ishte ndjekur.”

Vitore Tusha përgjigjet se nga aktet e dërguara nga prokuroria dhe SHÇKB-ja nuk ka gjetje. Të dhënat janë siç janë prezantuar. Megjithatë, gjetjet e ardhura nga organet e tjera për këtë çështje duhen diskutuar dhe duhet parë akti origjinal në tërësinë e tij, pra jo vetëm ato që janë deklasifikuar, i cili ka një përmbajtje më të gjerë, pasi nuk është vetëm ky episod, por ka dhe më shumë informacion.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje apo sqarime.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se për pjesën e integritetit nuk ka pyetje të tjera. Në lidhje me eksperiencën e punës, e konkretisht me gjetjet që ka në lidhje me vitet e tij të punës, shprehet se kandidati e ka pranuar se megjithëse ka licencën nga viti 2006, ai nuk e ka ushtruar këtë profesion deri në vitin 2009, pra nuk është se ka mospërputhje midis deklarimeve të tij dhe deklarimeve të cilat janë bërë nga Dhoma e Avokatisë, të cilët e nxjerrin si avokat aktiv që nga viti 2006.

Vitore Tusha pyet se cili është qëndrimi i Avokates së Popullit në lidhje me procedurën e ndjekur për këtë kandidat. A është e plotë dhe e zauruese?

Erinda Ballanca merr fjalën: “Në gjykimin e Avokatit të Popullit, procedura e hetimit për ato që janë çështje që duhet të realizohen nga KED-ja deri në këtë moment, është e plotë, pra të dhënat janë të plota për të çuar në vendimmarrje, në lidhje me dy kritere të cilat janë konsideruar problematike, kriteri tjetër ka ardhur nga ILDKPI-ja është i pastër, s’ka pasur problematika të tjera, as nevojë për të ndryshuar ndonjë pjesë të deklaramit nga përgjigjet që na kanë ardhur.”.

Vitore Tusha në cilësinë e relatores vijon relatimin për kandidatin Përparim Kalo. Lexon të plotë relacionin. Sqaron se relacioni i është njoftuar kandidatit, anëtarëve, Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të tjerë sipas ligjit dhe është njoftuar publikisht si pjesë e rendit të ditës në faqen e Gjykatës së Lartë.

Pyet anëtarët dhe Avokatin e Popullit nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët nuk kanë pyetje.

Erinda Ballanca shprehet se procedura ka qenë e plotë, pra i është dhënë mundësi kandidatit të paraqesë të gjitha provat në mënyrë shteruese për të siguruar, garantuar dhe provuar pajtueshmërinë tij në kriteret e përcaktuara në vijim në Kushtetutë dhe në ligj.

Vitore Tusha vijon me pikën e tretë të rendit të ditës dhe propozon që ajo të spostohet dhe të vijohet me pikat e tjera të rendit të ditës dhe kjo pikë të ngelet për në fund të mbledhjes, edhe për ekonomi të procedurës.

Anëtarët me shumicë votash miratojnë propozimin për të lënë pikën 3 të rendit të ditës në fund të kësaj mbledhjeje (votuan pro: Fiona Papajorgji, Arta Marku, Miranda Andoni dhe Vitore Tusha. Votuan kundër: Saida Dollani dhe Ludovik Dodaj).

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se: “Siç u shpreha në fillim të kësaj mbledhjeje nëse do të ndjekim rendin e ditës siç është miratuar, për mua s’ka problem. Pra, unë duroj dalim jashtë (*i referohet momentit që Këshilli futet në dhomë Këshillimi, për bisedim dhe vendimarrje*) dhe njoftohemi prapë për të riardhur në mbledhje. Pas vendimarrjes (*i referohet pikës 3*) mbyllet procesi i verifikimit dhe ne si organ emërtese informohemi kështu mbi kandidatët e lejuar që ngelen në garë. Ndoshta Këshilli mund t’i kursente kohë vetes që intervistën e planifikuar me kandidatin Altin Binaj (*sipas pikës 7 të rendit të ditës*) ta realizojë edhe për vakancën tonë, që të kalonte kështu në procesin e vlerësimit të tij.”

Vitore Tusha pyet se si mund të bëhet pa e thërritur, pasi nuk është në rendin e ditës.

Bledar Dervishaj shprehet se, mund të merret një vendim për të njehsuar intervistën e z. Binaj të vlefshme si për vakancën e Kuvendit dhe për vakancën e Presidentit. Kjo mund të bëhet për të kursyer kohë e burime, pasi duhet thërritur prapë kandidati. Kjo lidhet dhe me logjikën e Këshillit për shpejtësi. Pra, mund të kalohet te faza e vlerësimit.

Erinda Ballanca shprehet se ndoshta Këshilli nuk ka nevojë ta intervistojë më, ndoshta e ka të qartë natyrën e informacionit që mund të merret nga intervista edhe për vlerësimin në vakancat e tjera.

Vitore Tusha sqaron se kjo është bërë më parë, por sot nuk është në rendin e ditës dhe është kërkesë që të merret një vendim për fillimin e procedurës së pikëzimit dhe për vakancën e Presidentit.

Bledar Dervishaj merr fjalën: “Këtë mund ta kërkoj vetëm pasi të informohemi mbi vendimarrjen e Këshillit (*i referohet pikë 3 të rendit të ditës*), prandaj po shprehem në këtë mënyrë. Pra nëse marrin vesh se çfarë vendosi Këshilli, prandaj po e shpreh tani në parim. Ju e dini vetë por, ndërkohë që ne jemi shprehur në mbledhjet pararendëse më 26 nëntor që Këshilli të hyjë në procesin e vlerësimit për vakancën tjetër që ka dy kandidatë, si mos të shprehemi në të njëjtën mënyrë për vakancën tjetër që sot mund të këtë tre kandidatë? Kështu që ju gjykojeni si të jetë më e mira.”

Fiona Papajorgji merr fjalën dhe shprehet se pa filluar procedura e pikëzimit për një vakancë të caktuar nuk mund të fillohet intervista. Në rastin në fjalë në momentin që procedura e pikëzimit dhe renditjes do të fillojë dhe për vakancën e shpallur nga Presidenti, Këshilli mund të vlerësojë nëse do të bëhet përsëri intervistë e re apo jo.

Vitore Tusha vijon me pikën 4 të rendit të ditës. Shprehet se: “Zonja Saida Dollani, relatorja e vakancës së Kuvendit për vakancën e parakohshme, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018, rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020, më ka informuar, më ka njoftuar se ka përfunduar verifikimi i të gjithë kandidatëve në këtë vakancë dhe se ka përfunduar edhe koha sipas të cilës kandidatët e ndaluar mund të ushtronin ankim në Gjykatën e Apelit. Në lidhje me këtë fakt, ne kemi njoftimin e zonjës Dollani, po ashtu ne kemi vendimet e marra nga Këshilli dhe dëftesat e komunikuar si për zotin Ilir Haznedari, i cili ka marrë dijëni dhe unë jua kam njoftuar në mbledhjen e mëparshme dhe nuk është ankimuar, ashtu edhe për zonjën Ardita Buna, e cila ka marrë dijëni për vendimin në datën 30 nëntor dhe nuk është ankimuar, duke llogaritur edhe datën 7 të plotë, që do të ishte data 5, por data 7 përkonte me plotësimin e afatit 5-ditor, siç parashikon ligji kur dita e 5-të bie të shtunën, të dielën apo festa zyrtare. Kështu që pas komunikimit edhe me Gjykatën e Apelit, me sekretarin e Gjykatës së Apelit, se na kanë njoftuar se nuk ka asnjë ankim të depozituar, pra, nga data 7 deri në ditën e sotme kanë kaluar disa ditë më tej, nuk kemi ndonjë ankim të depozituar nga kjo ankuese. Pra, në këtë listë mbetet i lejuar vetëm kandidati Altin Binaj. Mbi këtë bazë, mbi njoftimin e relatores me shkrim të depozituar dhe përcjelljen e relacionit të saj, unë kam planifikuar në rendin e ditës edhe këtë pikë, këtë çështje dhe vlerësoj, ju ftoj që të

vendosim për shpalljen e fillimit të procedurës të vlerësimit, të pikëzimit e kësaj vakance Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes të kandidatit për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020. Arsyet në i kemi diskutuar edhe në mbledhjet e mëparshme dhe arsyeja më kryesore duke dashur të mos i përmbledh përsëri, por ka qenë vullneti i shprehur i përfaqësueses të Kryetarit të Kuvendit, i deklaruar këtu që edhe nëse lista është nën 3 kandidatë, ne nuk do të bëjmë më rishpallje tjetër, por duam që të vazhdoni procedurën dhe të na i përcillni. Mbi këtë deklaram dhe mbi këto fakte, unë kam vendosur ta planifikoj në rendin e ditës së sotme dhe ju ftoj që të marrim vendim, sepse duhet ta formalizojmë me një vendim, të nënshkruar nga të gjithë, sepse vërtet është vendim i ndërmjetëm, por ka vlerën që duhet të jetë i nënshkruar nga të gjithë. Draftin e kam përpiluar, por ju ftoj paraprakisht për ta miratuar fillimin e procedurës, të vlerësimit (verifikimit), pikëzimit dhe renditjes së kandidatit për këtë vakancë.”.

Fton anëtarët të shprehen në lidhje me këtë propozim.

Anëtarët miratojnë fillimin e procedurës së vlerësimit dhe të pikëzimit.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë sugjerim Avokati i Popullit?

Erinda Ballanca shprehet se nuk ka gjë për të shtuar.

Vitore Tusha fton anëtarët të vijojnë me nënshkrimin e vendimit për fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018, rishpallur në datën 21.08.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.

Vitore Tusha shprehet se në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës, që është miratimi i ekspertit të gjuhës së huaj në funksion të realizimit të intervistave për kandidatin e lejuar, paraprakisht i është drejtuar Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Departamentit të gjuhës italiane, gjuhë në të cilën vetë kandidati kishte kërkuar të intervistohet. “Ditën e djeshme kandidati ka informuar me shkrim që nuk e vlerëson të zhvillojë këtë intervistë në gjuhën e huaj, prandaj nuk është lajmëruar pedagogia. Relatorja do të bëjë prezent aktin e komunikimit të tij. Kështu që në lidhje me këtë pikë nuk ka vend për vendimmarrje sa kohë që nuk do të zhvillohet kjo procedurë”.

Vijon me pikën tjetër të rendit të ditës që lidhet me relatimin për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës të kandidatit të lejuar. I jep fjalën relatores Saida Dollani.

Saida Dollani parashtron të plotë relacionin për procedurën e vlerësimit për kandidatin zotin Binaj. Sqaron se zoti Binaj, nëpërmjet rrugës elektronike, kishte përzgjedhur gjuhën Italiane, por nëpërmjet rrugës elektronike në datën 11.12.2020 ka dërguar njoftimin se heq dorë nga e drejta e tij për t’u intervistuar në gjuhën e huaj Italiane. Relacioni dhe e gjithë procedura i është njoftuar zotit Binaj, i cili në mënyrë elektronike ka konfirmuar marrjen e relacionit.

Vitore Tusha pyet nëse anëtarët dhe Avokati i Popullit kanë pyetje apo komente.

Anëtarët nuk kanë pyetje apo sqarime.

Erinda Ballanca pyet: “Zonja Dollani, unë e kam lexuar relacionin tuaj dhe e dëgjova me shumë vëmendje. Ju falënderoj për punën e bërë. Kam vetëm një pyetje. A ka ndonjë dokument për shkak të procedurës së vlerësimit, duke qenë se edhe neve na kanë ardhur në momentin fundor dhe mundet që mos ta kemi parë për ta verifikuar, që të vërtetoj që kandidati ka eksperiencë në fushën e të drejtave të njeriut, është aktivist në fushën e të drejtave të njeriut, përtej punës së tij si prokuror?”

Saida Dollani merr fjalën: “Aktivist i të drejtave të njeriut, në çfarë kuptimi? Sepse unë për shembull mund t’u kthej një përgjigje në kuptim të gjerë të fjalës. Të jesh prokuror i republikës nuk diskutohet fare që je në fushën e të drejtave të njeriut dhe unë jo pa qëllim e thashë, sepse vetë ligji kërkon përvojën në një fushë dhe e kam theksuar disa herë, sepse e

pashë në këtë këndvështrim, ka përvojën në fushën e së drejtës penale. Dhe mbani këtu në konsideratë, zonja Avokate e Popullit, që në bazë të Kushtetutës së Republikës, por edhe të ligjeve specifike, prokurori, ashtu si gjyqtari është administrues i drejtësisë.”.

Erinda Ballanca replikon “Unë kam koncept të ndryshëm”.

Saida Dollani merr fjalën: “ Juve nuk ma thatë se cili ishte koncepti i të drejtave të njeriut, por të drejtat e njeriut parashikohen në Konventën për të Drejtat Evropiane të Njeriut që nuk diskutohet një hapësirë të zgjeruar i lë edhe në këndvështrimin që them unë. Unë nuk di që në Gjykatën e Strasburgut p.sh. të jetë marrë një vendim kundër Shqipërisë, që të ketë qenë prokuror zoti Binaj dhe të jenë shkelur të drejtat e njeriut. Kështu që mendoj që i ka respektuar të drejtat e njeriut të parashikuar nga konventat dhe nga ligjet procedurale penale, porë në këndvështrimin tuaj. Kaq sa unë kuptoj pyetjen.”.

Vitore Tusha pyet përfaqësuesen e Kryetarit të Kuvendit, nëse ka pyetje.

Mimoza Arbi përgjigjet “Jo”.

Vitore Tusha deklaron të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës për të vijuar me intervistën.

Bëhet një pushim i shkurtër.

Vitore Tusha vijon mbledhjen me intervistën me kandidatin për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datat 21.08.2019 dhe 24.09.2020, zoti Altin Binaj. I bën me dije kandidatit se ai e ka paraqitur platformën dhe se mund bëjë prezantimin e tij para Këshillit dhe se anëtarët nëse do të kenë pyetje do ia drejtojnë.

Kandidati Altin Binaj merr fjalën: “Faleminderit zj. Kryetare, të nderuar anëtarë të KED dhe të ftuar të tjerë. Për mua është vlerësim që ndodhem para jush në këtë seancë dëgjimore që zhvillohet në një periudhë problematike nga pikëpamja shëndetësore dhe dua t’ju uroj të jeni mirë me shëndet si ju dhe familjarët tuaj. Ju e shpjeguat vijimin e kësaj seance dhe ajo parashikon paraqitjen e platformës mbi motivet e kandidimit tim dhe objektivat që synoj të arrij nëse do të zgjidhem anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Unë kam përgatitur një material me shkrim me mendimin për ta depozituar në fund të fjalës time, ndërkohë që gjatë ndërhyrjes time në mënyrë të përmbledhur të shpjegoj duke u përpjekur të jem racional me kohën këto elemente që pastaj të jem në dispozicion të anëtarëve të KED për pyetje eventuale.”.

Kandidati Altin Binaj parashtroi në mënyrë të përmbledhur platformën e tij me shkrim dhe e paraqiti para Këshillit.

Vitore Tusha i jep fjalën anëtarëve për pyetje.

Saida Dollani merr fjalën. Shprehet se personalisht është hera e parë që e dëgjon të flisni në lidhje me motivacionet përveç asaj që është paraqitur me shkrim. “Unë nuk kam pyetje për tu bërë, jam shumë e qartë sepse si relatores kam analizuar dhe nga ato që ju keni shkruar dhe nga jetëshkrimi juaj çdo gjë e dhashë në relacionin tim. Por dëshiroj të informoj anëtarët e Këshillit se përveç sa është shkruar në relacion që janë faktet e gjetura gjatë procedurës, është një fakt tjetër shumë domethënës dhe komunikimi shumë korrekt nga z. Binaj me relatorin, një komunikim me të vërtetë shumë i pëlqyeshëm dhe realisht i është përgjigjur çdo pyetje apo çdo sqarimi që Këshilli ka kërkuar në kohë reale dhe mënyrë shumë dinjitoze.”.

Kandidati Altin Binaj: “Ju faleminderit z. Dollani për vlerësimin dhe po marr shkas nga ndërhyrja juaj e fundit për të sqaruar diçka që mund ta sqaroja dhe pjesërisht. Në fakt ka të bëjë me intervistimin në gjuhë të huaj. U shkaktua një keqkuptim nga ana ime, nuk isha i qartë që duhet të isha gjithsesi në seancën e sotme, të isha dhe për seancën dëgjimore. Mendova se do të isha vetëm për intervistën dhe kam bërë një komunikim dje që heq dorë

dhe për shkak të keqkuptimit tim ekspertit mund të mos jetë thirrur sot por nëse ekspertit është paraqitur sot unë jam i gatshëm të bëj intervistën. Në qoftë se jo, kjo ka ardhur për shkak të keqkuptimit tim dhe i qëndroj komunikimit tim. Faleminderit.”

Vitore Tusha komunikon për t`u evidentuar në procesverbal, se gjatë kohës që po fliste z. Binaj është larguar përfaqësuesi i presidentit z. Dervishaj dhe është paraqitur në vend të tij znj. Treska.

Saida Dollani shprehet se pas kësaj që dëgjova nga z. Binaj që për hir së të vërtetës është e dukshme që mund të jetë dhe një keqkuptim dhe me sa kuptova ju kishit dhe problemin e Covidit dhe nuk donit të paraqiteshit personalisht për shkak të rastit pandemi. Por unë do t`i sugjeroja Këshillit duke qenë se jeni njohës dhe një pjesë e mirë e jona është njohës e gjuhës Italiane nuk ka nevojë për ekspert dhe mund t`i drejtohem pyetje dhe në gjuhën Italiane ose nëse dëshiron që një pjesë të motivacionit ta prezantoj në gjuhën Italiane personalisht unë jam e prirur pasi e kuptoj.

Vitore Tusha shprehet se është dakord.

Fiona Papajorgji shprehet se është dakord.

Miranda Andoni shprehet se nuk është dakord nëse kjo intervistë nuk bëhet nga specialist i gjuhës se huaj.

Saida Dollani shprehet se vetë akti nënligjor e lejon dhe prandaj dhe është dakord të vijojë pasi disa nga anëtarët e njohin shumë mirë gjuhën italiane dhe mund të bëjnë përkthyesen, interpretin në mënyrë të shkëlqyer.

Ludovik Dodaj nuk e gjen me interes të ndalojë tek gjuha e huaj pasi për të qenë në rregull me procedurat duhet të jetë ekspertit.

Vitore Tusha pyet nëse Avokatja e Popullit ka ndonjë koment për procedurë.

Erinda Ballanca shprehet: “Në lidhje me çështjen procedurale unë kam njohuri në gjuhën italiane dhe mund ta asisitoj Këshillin në lidhje me këtë aspekt, nuk marr pjesë në vlerësim dhe mund të jap mendimin tim sa i përket njohurive, ndërkohë që sigurisht është e drejta e vetë kandidatit që të kërkoë ai të vlerësohet nga një ekspertit i licencuar dhe në kuadër të kërkesës që ai mundet ti paraqesë këtij këshilli unë mendoj se duhet që të vlerësohet dhe në përfundim këtë çështje. Nëse ai mendon se këshilli duhet ta vlerësojë një ekspertit ose këshilli ta dëgjojë është një e drejtë e kandidatit.”

Vitore Tusha i jep fjalën kandidatit të shprehet në lidhje me propozimin e anëtares.

Kandidati Altin Binaj konfirmon se heq dorë nga intervistimi në gjuhë të huaj dhe duke konfirmuar heqjen dorë mua do i mjaftonte që në një moment të vulltshme të bëjë një intervistë e thjeshtë të gjuhës italiane pa pikëzim për të krijuar bindjen të anëtarët e KED dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjerë për vërtetësinë e asaj që unë kam deklaruar. Faleminderit.

Vitore Tusha u jep fjalën anëtarëve për pyetje.

Fiona Papajorgji merr fjalën dhe shprehet: “Nga fjala juaj dhe platforma që paraqitët thatë se si prokuror, duke qenë se gjykimi incidental mund të fillohet dhe me iniciativë të palëve, disa herë i keni propozuar gjykatës që të pezullojë gjykimin dhe të dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Duke qenë se ju kandidoni si gjyqtar për Gjykatën Kushtetuese, mund të na prezantoni ndonjë nga këto raste për çfarë neni është bërë konkretisht kërkesa juaj dhe nëse është marrë parasysh nga gjykata.”

Kandidati Altin Binaj falënderon për pyetjen. Kanë qenë dy raste me sa kujton. Një rast ka qenë kërkesë individuale, rreth vitit 99, ku ka qenë përfaqësuesi i akuzës “vrasje” që përmbante dënim me vdekje dhe i ka kërkuar gjykatës së Vlorës të pezullonte gjykimin dhe të dërgonte çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për deklarimin si të papajtuësëm me Kushtetutën të parashikimit në Kodin Penal për dhënien e dënimit me vdekje. Në atë kohë kishte hyrë në fuqi moratoriumi me Këshillin e Evropës dhe prej disa vitesh nuk ekzekutohej dënimi me vdekje, por gjykata për fat të keq nuk mori parasysh kërkesën. Pavarësisht

arsyetimit ligjor në vendimin e ndërmjetëm shkaqet lidheshin me afate dhe me cilësinë e të pandehurit, që ishte i arrestuar. Disa muaj më vonë Gjykata Kushtetuese u shpreh pikërisht për papajtueshmërinë e parashikimit në Kodin Penal me parashikimin kushtetues për mbrojtjen e jetës. Rasti i dytë nuk ka qenë një kërkesë individuale, është në Gjykatën e Apelit të Vlorës, ku kemi pasur një diskutim me kolegun e zyrës së Prokurorisë së Apelit dhe mbi bazën e një kërkimi gjykata e apelit ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese çështjen e vlerësimit të pajtueshmërinë me Kushtetutën, me ndryshimet që ka pësuar pas ligjit nr. 35/2017 instituti i riçeljes së shqyrtimit gjyqësor në apel, të rastit kur i pandehuri në shkallë të parë ka marrë pafajësi por ka përfutur gjykim të shkurtuar dhe gjykata e apelit nuk mundet, nëpërmjet një vlerësimi të ndryshëm të provave, të ndryshojë pafajësinë. Gjykata e apelit ka parashtruar para Gjykatës Kushtetuese se përbën shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor cenimi i një të drejte të fituar tashmë në gjykatën e shkallës së parë. Ky ka qenë një opinion i diskutuar në zyrë dhe i është prezantuar gjykatës dhe gjykata e ka pranuar.

Ludovik Dodaj merr fjalën. Shprehet se me z. Binaj jemi kolegë të hershëm dhe vlerëson shprehjen e interesit dhe platformën që ka paraqitur në të gjitha aspektet. Pyet, nisur nga profesioni i përbashkët, se keni paraqitur 5 materiale nga këto janë tre rekurse nuk po them për rekurse të 2020, por mund të më thoni për rekursin që është bërë në 2017 si ka përfunduar në Gjykatën e Lartë. Bëhet fjalë për vendimin nr. 522, datë 11.07.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Kandidati Altin Binaj përgjigjet se e kujton rastin dhe mendon se nuk është shqyrtuar rekursi pasi Gjykata e Lartë nuk ka funksionuar. Shprehet se çështja është serioze nuk është nga ato që edhe me plotësimin e dhomës së këshillimit, mund të vendoset mospranimi.

Arta Marku shprehet se nuk ka pyetje pasi e njeh z. Binaj, ka pasur rastin të punojë me të. E falënderon për kandidimin në këtë moment kaq delikat, pasi është me tepër se sa një kandidim i thjeshtë sepse është një kontribut për formimin e Gjykatës Kushtetuese dhe është e bindur që me vlerat që përfaqëson do jetë një vlerë e shtuar për këtë gjykatë.

Kandidati Altin Binaj e falënderon për vlerësimin.

Vitore Tusha ka një pyetje që lidhet me mënyrën se si e mendon bashkëpunimin në kolegjalitet për shkak të vështirësisë profesionale, duke qenë se si prokuror është ai vetë që i ndërmerr veprimet dhe që i ekzekuton, ndërkohë që në një organ kolegjal duhet gjithmonë të ketë bashkëveprim për të ndarë dhe shkëmbyer mendime derisa të arrihet një vendimmarrje. Si do të përshtatej veprimtaria e tij në një trupë kolegiale.

Kandidati Altin Binaj përgjigjet se është pyetje e drejtë. Është e vërtetë ajo që thoni ju, natyra e veprimtarisë të prokurorit prezumon se është një, sidomos pas ndryshimeve të fundit është aktiviteti tërësisht individual, por nuk është vetëm kështu aq më tepër nga eksperiencia jonë si prokurorë, sepse edhe prokurori në faza të ndryshme pas procedurës do të duhet të punojë në grup. Në fazën e hetimit paraprak punon me policinë gjyqësore duke rakorduar veprimtarinë hetimore, pastaj nxjerr konkluzionet përkatëse për akuzën. Punon në grup në rastet e grupeve të përbashkëta hetimore, të përbërë me më shumë se sa një profesionist i të drejtës penale dhe nga ana tjetër do të doja të theksoja që eksperiencia ime gjatë këtyre viteve ka përfshirë edhe drejtimin e një sërë zyrash e prokurorish sepse në fakt ka qenë e domosdoshme të punoja në grup e të organizoja. Mendoj se për një prokuror që ka shumë vite në sallën e gjyqit është më kollaj që të orientohet edhe me parimet e kolegjalitetit sepse njeh gjithë gjykimin, parimet e të cilit me specifikat e veta janë po ato në gjykimin kushtetues. Një eksperiencë e tillë e gjatë jo vetëm në punën në grup por dhe në sallat e gjykatës besoj se do më lejojnë që të përshtatem relativisht mirë me parimin e kolegjalitetit.

Vitore Tusha e falënderon kandidatin që ka konkurruar pasi KED vazhdon të jetë në kërkim të kandidateve për plotësimin e vakancës në Gjykatën Kushtetuese dhe është shumë me rendësi që të ketë kandidatë me cilësi, që konkurrojnë e më pas të zgjidhen në këtë detyrë.

I uron suksese, duke e falënderuar për cilësitë e tij të cilat janë prezantuar nga të gjitha institucionet dhe shpreh konsideratën për kandidatin.

Kandidati Altin Binaj falënderon dhe shprehet: “Dëshiroj të them një fjali të fundit për Këshillin, që për arsye të racionalitetit kohor nuk e thashë në ndërhyrjen time me gojë por që e keni të shkruar në materialin me shkrim. Ju falënderoj dhe kam shprehur vlerësim shumë pozitiv, lidhur me komunikimin gjatë gjithë këtyre fazave të vlerësimit të kandidaturës time, sidomos për respektimin në mënyrë maksimale nga KED të procedurave ligjore. Ju falënderoj, gjithashtu, me bindje të plotë për objektivitetin e një procesi të tillë dhe jam tërësisht i bindur se vendimmarrja juaj do jetë objektive për sa i përket kandidaturës time.”.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë koment Avokati i Popullit dhe përfaqësuesi i kryetarit të Kuvendit.

Nuk ka komente.

Vitore Tusha mbyll këtë seancë të intervistës duke falënderuar kandidatin.

Fton Avokaten e Popullit që të prezantojë çështjen që dëshironte të ngrinte të pika e rendit të ditës “Të tjerë”.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se ka vërejtur, ka parë me shumë vëmendje vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ, me anë të të cilit për herë të dytë për kandidaten Zhaklina Petro është kthyer në Këshill vendimmarrja në lidhje me verifikimin dhe plotësimin e kushteve nga kjo kandidate. Ndryshe nga herët e tjera të ankimit të bërë nga kjo kandidate apo dhe të kandidatëve të tjerë, institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka qenë e thirrur si palë në këtë proces dhe nuk kemi qenë të pranishëm gjatë seancës.

Vitore Tusha komunikon se u largua znj. Treska dhe në vend të saj është rikthyer në mbledhje z. Dervishaj.

Erinda Ballanca vijon fjalën. Pavarësisht sa me sipër duke e quajtur si të drejtë të kandidatit që të përcaktojë se cilët duhet të thërrasë në gjykim, në cilësinë e personit të tretë apo jo, ne e lexuam me shumë kujdes vendimin e gjykatës të Apelit i cili është bërë publik dhe në faqen e KED. E kemi marrë nga faqja, në fakt do kisha një çështje në të cilën nga leximi rezulton se vendimmarrja në thelb konsideron se Këshilli nuk ka plotësuar detyrat e lëna nga gjykata e mëparshme e Apelit në vendimmarrjen për rastin në vendimmarrjen në rastin konkret, konkretisht në vendimin nr 94, datë 10.11.20. Unë në asnjë pikë të këtij vendimi nuk kam gjetur ndonjë nga detyrat që konsideron gjykata aktuale e Apelit si detyra të lëna në lidhje me llojin dhe natyrën e hetimit apo vendimmarrjes që duhet të bënte Këshilli. Në këto kushte nëse ka ndonjë vend për sqarim interpretim nga gjykata e Apelit do të kërkoja Këshillit që ta kishte në konsideratë për vendimin 94 jo për vendimin aktual, ta kishte në konsideratë këtë kërkesë, që nëse do kishte ndonjë lloj vendimmarrje të mund ta adresojë sa me parë në mënyrë që të përfundonte kjo procedure brenda mandatit tuaj.

Vitore Tusha pyet nëse sugjeron që t'i kërkojë Gjykatës së Apelit të na interpretojë vendimin e mëparshëm i cili është zbatuar dhe është pasur në konsideratë.

Erinda Ballanca përgjigjet se, nëse ka detyra të karakterit procedural të lëna nga Gjykata e Apelit në vendimin 94 unë personalisht por dhe këshilli nga gjithë vendimmarrja diskutimi kemi menduar se kemi realizuar të tera. Ky vendim i ri identifikon të vendimi i parë detyra të tjera, të cilat nuk i kam lexuar në asnjë resht të vendimit 94. Ndoshta dhe Këshilli jo, por është e pamundur që gjykata aktuale e apelit të nxjerrë detyra të tjera, nëse ka pasur ndonjë problem me lidhje me sqarimin interpretimin vendimmarrjen e atyre personave dhe duhej ta kishte bërë ajo gjykate dhe jo një gjyqtar tjetër. Për në ishte e qartë se ishte vetëm një detyrë e lënë siç e kam lexuar unë dhe këshilli, e thjeshtë kjo detyrë e lënë nga ajo gjykate është plotësuar.

Vitore Tusha shprehet se në atë vendim vetëm një detyrë është lënë, dhe se në ka një pasaktësi totale në lidhje me mospërgatitjen e projektaktit. Asnjë kandidat nuk është shqyrtuar pa projektakt. Pyet se çfarë zgjidh kjo çështje. Detyra e Këshillit është të marrim

vendimin, të lexojmë çfarë detyrash ka dhe të ecim përpara. Do të ushtrojmë kompetencën që kemi. E njohim fuqinë e vendimeve gjyqësore dhe do përpiqemi të lexojmë në çdo rresht, si dhe herën e parë. Pyet se çfarë mendimi kanë koleget?

Erinda Ballanca shprehet se nuk ka një mendim të ndryshëm, në kuptimin që do të donte të shihet çfarëdolloj problematike që mund të arrihet në kohë për të adresuar çështjen e kohës, që Këshilli të mund të marrë një vendim në lidhje me këtë vakancë, pasi në gjykimin e Avokatit të Popullit është një shkelje shumë e rëndë e të drejtave të njeriut vazhdimi i mbajtjes së këtij vendi pa Gjykatë Kushtetuese. Ky ishte thelbi.

Fiona Papajorgji merr fjalën dhe shprehet se është dakord në parim me atë që thotë Avokatja e Popullit pasi vendimet lenë vend në disa aspekte për t'u sqaruar. Por nëse do të kërkohej interpretimi i vendimit të mëparshëm të Gjykatës Administrative të Apelit, do të dukej sikur nuk është kuptuar vendimi i mëparshëm. Mendon se Këshilli atë vendim e ka kuptuar dhe zbatuar. Duke marrë shkas nga fjala e Avokates së Popullit për prioritetin që ka ngritja e Gjykatës Kushtetuese dhe impenjimin e Këshillit që sa më shpejt të bëjë të mundur funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, shprehet se një veprim i tillë domosdoshmërisht do të passillte shtyrje të afateve. Nga ana tjetër KED ka kapacitete të veprojnë dhe të zbatojë vendimin e dytë të Gjykatës Administrative të Apelit.

Arta Marku ndërhyt dhe shprehet se do vijë një moment për të diskutuar për çështjen e kandidatit në fjalë dhe do vendoset.

Miranda Andoni merr fjalën dhe shprehet se është njohur me përmbajtjen e vendimit të fundit të Gjykatës së Apelit Administrativ. Pavarësisht rezervave që kam në lidhje me këtë vendimmarrje jemi të detyruar ta zbatojmë. Në lidhje me sugjerimin për të kërkuar sqarim dhe interpretim jam e mendimit se kjo do të vononte shumë procesin, do ta vështirësonim në vend që ta lehtësonim ecurinë e mëtejshme dhe përveç kësaj nuk shikoj ndonjë paqartësi sa i përket vendimmarrjes së mëparshme. Nëse vendimmarrja aktuale e vendimin nr. 100 i është referuar vendimit nr. 94 kjo nuk do të thotë që ky vendim është i paqartë. Ne kemi qenë të qartë në vendimin nr. 94, e kemi zbatuar ndërsa vendimi 100 lë detyra për hetime pa përcaktuar drejtime. Ka vështirësi shumë në zbatimin e vendimit të fundit sepse lihet detyrë të kryhet një hetim por ndërkohë nuk ka drejtime të përcaktuara se ku duhet të drejtohet ky hetim.

Saida Dollani merr fjalën dhe shprehet se nuk është për t'iu drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ por falënderon Avokaten e Popullit që në vëzhgim të gjithë veprimtarisë së KED identifikoi problemin e te drejtës që gjithë vendi ka për të pasur një Gjykatë Kushtetuese funksionale. Duhet vazhduar këto procedura pavarësisht vendimeve që do lexohen me vëmendje dhe nëse ka hapësirë dhe vend për të reflektuar që është bërë një shkelje procedurale tepër e rëndë, siç e parashikon ligji do vazhdohet të riparohet ajo shkelje.

Ludovik Dodaj shprehet se në lidhje me shqetësimin që ngriti Avokati i Popullit, me të vërtetë krijohet zvarritje. Është e drejtë e subjekteve që të kërkojnë dhe gjykata të vendosë dhe Këshilli është i detyruar të respektojë vendimet e gjykatave sa më shpejt.

Vitore Tusha shprehet se Këshilli do lexojë në çdo germë vendimin e dhënë nga gjykata, çfarë detyrash nuk janë zbatuar dhe çfarë detyrash duhet të zbatohen. Çështja më kryesore janë standardet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës mbi procesin e rregullt. Sqaron se vendimi ka ardhur ditën e djeshme në Këshill dhe është publikuar menjëherë në faqen zyrtare dhe i është dërguar edhe relatores, e cila po vijon me kompetencat e saj. Në ditët në vijim do ketë një njoftim në lidhje me këtë çështje.

Bledar Dervishaj merr fjalën, dhe shprehet: "Lidhur me kërkesën për interpretim të vendimit të gjykatës, nisur nga diskutimi që lindi, mendojmë se Këshilli i ka të gjitha aftësitë profesionale që ta kuptojë mirë vendimin dhe të bëjë interpretimin e tij. Këtu e kam fjalën si për vendimin e parë të gjykatës, apo dhe për të dytin. Aq më tepër kur vendimi i parë i gjykatës është ekzekutuar nga këshilli. Gjykata ka gjetur sërish shkelje sipas logjikës së saj,

por është Këshilli që do të vendosi. Do të duhet dhe ka detyrimin ligjor dhe kushtetues të shprehet mbi përmbushjen e detyrave të lëna nga gjykata. Kështu që siç duket, Këshilli është i qartë si për vendimin e parë dhe për vendimin e dytë deri në këto momente. Më thellë dhe me detaje ne presim që kjo çështje të shqyrtohet sa më shpejt. Në qoftë se do më lejonit të vijoja me fjalën time mbyllëse meqë ne organet e emërtesës në këtë moment duhet të largohemi? Nëse po, e marr tani fjalën e ta përmbyll. Sa i takon vakancës tonë tjetër të Presidentit, asaj të lënë bosh nga ish-gjyqtari B.Imeraj aktualisht kemi të kualifikuar dy kandidatë z. Altin Binaj, z Aleksandër Toma, ndërkohë që Këshilli tani do të hyjë në dhomën e këshillimit, do diskutojë dhe do të marrë vendim për zotin Klajdi Mone dhe zotin Përparim Kalo. Njësoj si për vakancën tjetër, ne shprehim vullnetin tonë që, këshilli pas vendimmarrjes të vijojë me procesin e vlerësimit sipas nenit 238 pika 3, nenit 239 pika 1 dhe nenit 240 të ligjit nr.115/2016, pas mbylljes së procesit të verifikimit, bërjes publike të rezultatit të verifikimit, njoftimin menjëherë dhe të vendimeve. Mirëpresim njoftimin tuaj për mbledhjen në radhës, që kërkoj të jetë sa më shpejt. Kaq kishim ne si përfaqësues të Presidentit.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë për të shtuar përfaqësuesja e Kryetarit të Kuvendit.

Mimoza Arbi shprehet se mirëpresim sa më shpejt kandidaturën për shkak të specifikës dhe veçorisë që ka Kuvendi, si organ kolegjal, ku votimi realizohet në seancën plenare. Beson se procedura është në përfundim.

Vitore Tusha sqaron se Këshilli vijon të jetë i mbledhur sipas ligjit pasi ka akoma për të diskutuar edhe çështje të tjera, ku përfshihet diskutimi dhe miratimi i listës përfundimtare të renditjes dhe i raportit përfundimtar, të cilat do përcillen menjëherë. Për këtë arsye nuk ka nevojë për rend dite pasi ai është i përcaktuar tashmë. Mbyll këtë seancë të mbledhjes së Këshillit dhe njofton që mbledhja do të vijojë ditën e hënë, ora 12:00.

Mbyllet mbledhja në orën 15.46.

Tiranë, më 11.12.2020

Zv/ KRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTARE

Miranda ANDONI

ANËTARE

Arta MARKU

Zv/ KRYETARE

Vitore TUSHA

ANËTARE

Ludovik DODAJ

ANËTAR

Saida DOLLAN

ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Vilma Dokushi